



Në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22, paragrafi 3, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, neni 11, paragrafi 4, i Rregullores Nr. 03/20023 për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 30.10.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Ekziston konflikti i interesit në rastin me Nr. Protokolli: DPKI-YSWZRK0095/25, për zyrtaren Suzana Aliu, u.d. Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), pasi që e njëjta në cilësi të, Udhëheqëse se Divizionit për Burime Njerëzore, ka nënshkruar Kontratën e Punës për kohë të caktuar Nr. Protokolli 01842, e datës 05.12.2024, për punësimin e D.D, person i afërmi i saj (vajza e vëlluat), në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 1, të LPKI-së.
- II. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit kërkon nga, Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP) ta revokoj/ shfuqizoj/aktin e nxjerrë nën rrethana të konfliktit të interesit (Kontratën e marrëdhënies së punës nr. prot.01842, e datës 05.12.2024), dhe më pas të njoftoj Agjencinë për vendimin final në lidhje me rastin, dhe ta bej iniciimin e procedurës disiplinore ndaj zyrtares Suzana Aliu, për shkeljet e dispozitave të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit;
- III. Lidhur me konstatimin për shkelje si në pikën I të dispozitivit, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit do të inicioj procedurën kundërvajtëse në gjykatën kompetente ndaj zyrtares së lartë znj. Suzana Aliu, u.d .Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore, Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP);
- IV. Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative si dhe të njëjtit bëhen publik në faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtaren Suzana Aliu, u.d. Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore, Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP), është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka filluar trajtimin e këtij rasti pas informatës së pranuar nga jashtë (në vijim: raportues i rastit), me pretendimin për konflikt të interesit pasi që, siç theksohet në kërkesë (citojmë):

"[...] znj. Suzana Aliu, në cilësinë e Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP) ka punësuar vajzën e vëllaut në pozitën Zyrtare Administrative, në Konkursin nr. RN00015790, e punësuar D. D [...]"

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ në kontekst të dyshimeve për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së, duke trajtuar dhe shqyrtuar këtë çështje vetëm sa i përket pretendimit se në pozitën zyrtare administrative është pranuar, punësuar me kontratë Pune për kohë të caktuar D.D. i cila sipas informacioneve është vajza e vëllait të, znj. Suzana Aliu, Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP), përkatësisht është trajtuar vetëm sa i përket vendimmarrjes së znj. Suzana Aliu, e cila në cilësi të (në vijim: Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP)), ka vendosur të nënshkruaj kontratën për vendin e punës Zyrtar Administrativ në divizionin për arkiv dhe administrim të dokumenteve në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP), sipas konkursit nr.RN00015790.

Kësisoj, Agjencia sipas procedurës së paraparë, nëpërmes shkresës zyrtare DPKI/1189/25, e ka njoftuar zyrtaren znj.Suzana Aliu, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në Agjenci, me ç ‘rast zyrtarja në fjalë është njoftuar me pretendimet e ngritura për konflikt të interesit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket këtyre pretendimeve. Në këtë takim, zyrtarja në fjalë ka paraqitur argumentet dhe qëndrimet e saj duke theksuar se : *“si Udhëheqëses e Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP) në asnjërin procedurë nuk kam qenë e përfshirë në komisionet përzgjedhëse, apo veprime tjera që kanë pasur rol vendimmarrës, dhe nuk kam marr asnjë veprim direkt apo indirekt që do të ndikonte në fillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën zyrtar administrative, dhe gjithë procedura është zhvilluara sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe kur ka përfunduar i gjithë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve fitues, duke vepruar sipas obligimeve ligjore që i parasheh ligji unë kam nënshkruar kontratën me nëpunësen fituese të përzgjedhur nga komisioni i pranimit duke vepruar sipas obligimeve ligjore ku të gjitha Kontratat dhe Akt-emërimet i nënshkruan vetëm Udhëheqësi i Personelit si veprim formal administrativ, edhe në këtë proces kam nënshkruar Kontratën e marrëdhënies së punës për kohë caktuar, Por që nuk kam qenë në dijeni se një çështje e tillë mund të paraqet konflikt të interesit. Po ashtu e njëjta ka theksuar se edhe në formë zyrtare do ta përgatis një sqarim të hollësishëm lidhur me këtë proces.*

Në takimin e mbajtur, përmes deklaratës sqaruese dhe dokumentacionit të ofruar në Agjenci (ZIE-01422/25), znj. Suzana Aliu, ka paraqitur argumentet dhe rolin e saj përkitazi me pretendimet e ngritura. Ndër të tjera, në takimin e mbajtur zyrtarja në fjalë ka deklaruar se : (citojmë nga përgjigja e znj.Suzana Aliu): *“[...]"*

Ashtu siç kemi theksuar edhe në përgjigjen e parë me deklaram në takim e konfirmoj përsëri në përgjigjësën e plotë se *në asnjërin procedurë nuk kam qenë e përfshirë në komisionet*

përzgjedhëse, apo veprime tjera që kanë pasur rol vendimmarrës, dhe nuk kam marr asnjë veprim direkt apo indirekt që do të ndikonte në fillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën praktikant apo zyrtar administrativë. Në kuadër të masës së Qeverisë së Republikës së Kosovës "Praktikë në Punë" si dhe duke marr parasysh mungesën e stafit, Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës, ka parashtruar kërkesë me datë 10.05.2024 tek Agjencia e Punësimit për lejin e angazhimit të tre praktikantëve.

Unë Suzana Aliu, nuk kam qenë pjesë e kërkesës për fillimin e procedurës e po ashtu në asnjë fazë apo mënyrë nuk kam qenë as pjesë e Komisionit Përzgjedhës për procedurën e pranimit të praktikantëve.

Pas miratimit nga Agjencia e Punësimit, me Vendim me numër ref:00894/24 të datës 25.06.2024, është emëruar Komisioni përzgjedhës për intervistimin dhe vlerësimin e praktikantëve, në përbërje prej: V.H,A.H-B, dhe F.G.

Pas intervistimit, sipas raportit të Komisionit Përzgjedhës, janë përzgjedhur 3 kandidatët e Intervistuar: D.D, R.E dhe V.K.

Në ndërkohë duke vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për zyrtarët publik,Neni37(2,3,4)dhe Rregullores (QRK)Nr.03/2024 për Themelimin e Mardhenjës së Punës me kontratë për periudhë të caktuar, Neni 8,me datë 14.01.2024,është publikuar konkursi për pozitën Zyrtar Administrativ, në kategorinë Profesional 3,sipas përshkrimit të vendit të punës të miratuar në pajtim me Rregulloren Nr.01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës(AKKVP),po ashtu konfirmoj se procedurë të rekrutimit, unë nuk kam marr pjesë në asnjë nga hapat e këtij konkursi. Gjatë fazës së aplikimit për këtë pozita kanë marr pjesë 12 kandidat. Pas fazës së verifikimit paraparak,11 kandidat janë përfshirë në listën e ngushtë, dhe janë ftuar në intervistë me gojë.

Me vendimin me numër ref:01783/24 të datës 27.11.2024,është emëruar Komisioni përzgjedhës për pozitën e kategorisë profesionale "Zyrtar Administrativ "në këtë përbërje: M.E,A.H-B,,TG.

Në Intervistë kanë marr pjesë vetëm dy kandidat, dhe Komisioni ka bërë vlerësimin e intervistës sipas formularëve të rregullores, të cilat ju dërgohen si dëshmi.

Në bazë të renditjes përfundimtare të datës 03.12.2024,kandidatja D.D, ka arritur që të mbledh 74 pikë ,dhe është shpallur kandidat fitues .

Në pajtim me dispozitat e legjislacionit për zyrtarët publik si dhe Rregullores (QQRK) Nr.03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me kontratë për Periudhë Caktuar, me kandidaten fituese është nënshkruar Kontrata e Punës për Kohë të Caktuar, sipas dispozitave ligjore dhe shpalljes së konkursit.

Procedura rekrutimit për pozitën Zyrtar Administrativ, është zhvilluar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197,për zyrtarët publik,Neni37(2,3,4)dhe Rregullores(QRK)Nr.03/2024 për Themelimin e Mardhenjës së Punës me kontratë për Punë Për Kohë të Caktuar, si dhe Rregullores Nr.01/2024 për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Pasi ka përfunduar procedura e përzgjedhjes, pasi që Komisioni e Pranimit e ka bërë përzgjedhjen dhe publikimin e kandidatëve fitues, dhe pasi që ka përfunduar e tërë procedura e këtij konkursi, duke vepruar sipas obligimeve ligjore, unë e kam nënshkruar kontratën me nëpunësen fituese të përzgjedhur nga Komisioni i Pranimit, gjithnjë duke qenë e obliguar sipas procedurës administrative sepse në atë kohë isha duke e ushtruar pozitën e ushtruesit të detyrës së udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore, dhe sipas ligjit është obligim ligjor që të gjitha Kontratat dhe Akt-Emërimet i nënshkruan vetëm Udhëheqësi i Personelit, si një veprim formal administrativ pa fuqi vendimmarrëse, dhe gjithë procedura është zhvilluara sipas dispozitave ligjore në fuqi, dhe kur ka përfunduar i gjithë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve fitues, duke vepruar sipas obligimeve ligjore që i parasheh ligji unë kam nënshkruar kontratën me nëpunësen fituese të përzgjedhur nga komisioni i pranimit duke vepruar sipas obligimeve ligjore ku të gjitha Kontratat dhe Akt-emërimet i nënshkruan vetëm Udhëheqësi i Personelit si veprim formal administrativ, edhe në këtë proces kam nënshkruar Kontratën e marrëdhënies së punës për kohë caktuar, “[...].

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me qëllim të vërtetimit të lidhjes (eventuale) familjare përkatësisht afërsisë së znj. Suzana Aliu, me zyrtaren D.D, ka dërguar shkresën zyrtare DPKI-06-1639/25, dhe ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) - Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), e ku pastaj ka pranuar përgjigjen dhe dokumentacionin zyrtar nga Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC)–MPB,(DPKI-/05-1825/2025).

Nga informatat e pranuar nga raportuesi i rastit, takimi i mbajtur, shkresat sqaruese dhe dokumentacioni i dorëzuar në Agjenci nga znj. Suzana Aliu, përgjigja dhe dokumentacioni i siguruar nga ARC - MPB, si dhe nga informatat e siguruar sipas detyrës zyrtare, Agjencia ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Fakti se znj. Suzana Aliu, u.d. Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), e ushtron këtë funksion është konstatuar si dhe është pohuar nga zyrtarja në fjalë në takimin e mbajtur në Agjenci.

Ministria e Punëve të Brendshme me Data: 14-11-2024, ka shpallë konkursin Nr. referencës RNOOO15790, në bazë të Ligjit Nr.08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 37 (2, 3, 4) dhe Rregullores (QRK), duke u bazuar në kërkesën e adresuar tek njësia e burimeve njerëzore konkretisht tek znj. Suzana Aliu, nga znj. D.D, në emër të Aferdita Bekës, Drejtoreshë Ekzekutive, me arsyetimin që të ndërmerren të gjitha veprimet për shpalljen e konkursit sipas Rregullores (Qrk) Nr.03/2024, Për Themelimin e Marrëdhënies së Punës, me kontratë për punë për kohë të caktuar, për pozitën Zyrtar Administrativ, Profesional 3.

Me vendim me numër ref:01783/24 të datës 27.01.2024, është emëruar Komisioni përzgjedhës për pozitën e kategorisë profesionale “Zyrtar Administrativ” në këtë përbërje: M.E, u.d. udhëheqëse e divizionit; znj. A.H.-B, u.d. udhëheqëse e divizionit dhe znj. T.G, nga njësia e burimeve njerëzore.

Komisioni si më lartë, ka bërë vlerësimin e intervistës sipas formularëve individual, dhe në bazë të renditjes përfundimtare të datës 03.12.2024, kandidatja D.D, ka arritur që të mbledhë 74 pikë, dhe është shpallur kandidat fitues.

Më datë 05.12.2025, është lidhur Kontrata e marrëdhënies së punës për kohë të caktuar nr. prot. 01842, ndërmjet Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) të cilën e përfaqëson Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore .

Referuar përgjigjes dhe dokumentacionit të ARC - MPB, rezulton se znj. Suzana Aliu me të punësuarën D.D. kanë raporte të afërsisë familjare (vajzë e vëllaut- hallë).

Rrjedhimisht, raporti i afërsisë familjare ndërmjet zyrtares së lartë znj. Suzana Aliut dhe të punësuarit D.D. është lidhje (afërsi) e gjinisë së gjakut në shkallën e tretë.

Në vështrim të pretendimeve të ngritura dhe gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, Agjencia vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, për arsyet si në vijim:

I. Konstatimi si në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi se, ekziston konflikti i interesit në rastin APK-DPKI-YSWZRK-0095, për zyrtaren znj. Suzana Aliu, pasi që e njëjta në cilësi të, u.d. Udhëheqëses së Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), ka nënshkruar kontratën e mardhenjës së punës për kohë të caktuar, për pozitën Zyrtar Administrativ Profesional 3. nr. prot.01842, e datës 05.12.2024, me ç'rast është punësuar D.D. person i afërm i saj (vajza e vëllait-mbesa), është bazuar në nenin 17, paragrafi 1, lidhur me nenin 6 të LPKI-së.

Së këndejmi, konflikti i interesit është i lidhur ngushtë me *vendimmarrjen* e zyrtarit në një çështje të caktuar, në të cilën zyrtari ka apo mund të ketë *interes privat* për vete apo për *personat e afërm* me të.

Kështu, me nenin 6 të LPKI-së është përkufizuar nocioni i konfliktit të interesit, ashtu që: *“Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare”,* ndërsa me dispozitën e nenit 17 [Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit], paragrafi 1 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Çdo zyrtar gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetë deklarin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.”*

... lidhur me nenin 3 [Përkufizimet] paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të LPKI-së, me të cilin është përkufizuar se: *“interesi privat i personit zyrtar - nënkupton çfarëdo përparësie për personin zyrtar, familjen e tij, të afërmit, miqtë dhe personat apo organizatat me të cilat ai ka pasur apo ka marrëdhënie afariste”,* dhe nënparagrafi 1.6, me të cilin është përkufizuar se: *“Person i afërm me zyrtarin është – bashkëshorti ose personi që bashkëjeton, të afërmit në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, të afërmit në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, i afërmi në gjini të krushqisë deri në shkallën e dytë [...]”.*

Përveç kësaj, dispozita e nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.12 të LPKI-së, e definon nocionin vendimmarrje si: *“çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.”*

Në rastin konkret, është fakt i konstatuar se znj. Suzana Aliu, në cilësi të u.d. Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), ka qenë pjesë e vendimmarrjes duke nënshkruar Kontratën e marrëdhënies së punës nr. prot. 01842, e datës 05.12.2024, me ç'rast është punësuar D.D. person i afërm i saj. Gjithashtu, është fakt i konstatuar se kandidatja e punësuar në pozitën (D.D.) është vajza e vëllait-mbesa e zyrtares znj. Suzana Aliut. Pra në këtë rast, lidhja familjare ndërmjet personave në fjalë është brenda shkallës së ndaluar me dispozitat e LPKI-së (gjinia e gjakut, shkalla e tretë). Rrjedhimisht, znj. Suzana Aliu, në kundërshtim me dispozitat e sipërcituara të LPKI-së, ka marrë pjesë në *vendimmarrje* duke nënshkruar kontratën e punësimit në interes të personit të afërm të saj.

Me këtë rast, zyrtarja në fjalë nuk ka zbatuar obligimet që dalin nga dispozitat e nenit 5 [Parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit], paragrafi 8 i LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje”* dhe nenit 8 [Detyrimi për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit], paragrafi 1 të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se: *“Me marrjen e detyrës dhe gjatë ushtrimit të saj, zyrtari ka për detyrë të parandalojë dhe të zgjidhë vetë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit ndërmjet interesave të tij publike dhe private”*. Si dhe nuk ka ndërmarrë masat e përcaktuara me nenin 19 [Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesave], paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“1. Në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari sipas rastit dhe rrethanave: [...] 1.2. merr masa për vetë përjashtimin ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes, diskutimit dhe votimit të çështjes në konflikt [...]”*.

Nga sa u tha më lartë, vendimmarrja e znj. Suzana Aliu, përkatësisht nënshkrimi i kontratës për punë për kohë të caktuar, për pozitën Zyrtar Administrativ, Profesional 3. nr. prot. 01842, e datës 05.12.2024, për punësimin e D.D. personi i afërm i saj, paraqet situatë të konfliktit të interesit dhe si e tillë bie ndesh me nenin 17, paragrafi 1 lidhur me nenin 6 të LPKI-së.

II. Kërkesa e Agjencisë si në pikën dy të dispozitivit të këtij vendimi është bazuar në nenin 22 paragrafi 13 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit”*, nenin 24 paragrafi 5 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Agjencia inicion procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e akteve nga ana e institucionit që i ka lëshuar ato në konflikt interesi”*, pastaj në nenin 22, paragrafi 11 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Organet kompetente njoftojnë Agjencinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e njoftimit për veprimet e ndërmarra prej tyre”*, si dhe në nenin 19, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“2. Çdo udhëheqës i zyrtarit ose institucion udhëheqës merr masat e nevojshme, të përshkallëzuar dhe proporcionale për të shmangur paraprakisht dhe në çdo rast konfliktin real ose të mundshëm të interesave për shkak të zgjedhjes, emërimit apo caktimit të detyrave ose përgjegjësisë të caktuara të zyrtarit. Këto masa përfshijnë por nuk kufizohen: [...] 2.5. revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesave.”*

Andaj në kuptim të dispozitave të sipërcituara, Agjencia kërkon nga institucioni që ka nxjerrë aktin - (AKKVP), ta shfuqizoj /anuloj aktin e nxjerrë nën rrethana të konfliktit të interesit (Kontratën e marrëdhënies së punës nr. prot. 01842, e datës 05.12.2024), dhe më pas të njoftoj

Agjencinë për vendimin final në lidhje me rastin. Në këtë rast të merren në konsideratë edhe dispozitat përkatëse për anulimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme administrative.

III. Lidhur me konstatimin për shkelje të dispozitës së nenit 17, paragrafi 1 të LPKI-së, si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi, Agjencia konform nenit 23, paragrafi 3 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Për veprat kundërvajtëse, Agjencia dhe çdo institucion punëdhënës inicion procedurën kundërvajtëse në pajtim me ligjin”*, do të inicioi procedurën kundërvajtëse në gjykatën kompetente ndaj zyrtares Suzana Aliut, për faktin se sipas nenit 23, paragrafi 1, të ligjit në fjalë *“Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj e që nuk përbënë vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë si më poshtë [...]”*, në rastin konkret sipas nën-paragrafit 1.6 të këtij neni.

Për me tepër, me dispozitën e nenit 24 [Përgjegjësitë e tjera ligjore dhe pasojat mbi aktet], paragrafi 1 të LPKI-së, është përcaktuar se: *“Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësiive eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me rregullat që i rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe statusin e zyrtarëve. Institucionet/organizatat që i kanë iniciuar procedurat disiplinore sipas këtij ligji duhet ta njoftojnë Agjencinë për iniciimin dhe rezultatin e atyre procedurave.”*

Gjithashtu, kërkesa për iniciimin e procedurës kundërvajtëse bazohet edhe në dispozitën e nenit 17 [Fillimi i hetimeve administrative], paragrafi 7 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, me të cilën është përcaktuar se: *“Në rast se gjatë hetimit administrativ dyshohet për kundërvajtje, Agjencia inicion dhe zhvillon vet procedurën kundërvajtëse ose e referon atë në gjykatën kompetente në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.”*

IV. Agjencia vendosi si në pikën IV. të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”*, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: *“Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”*

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: *Pala e pakënaqur ka të drejtë të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh, nga data e pranimit të këtij vendimi.*

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Ylli BULESHIKAJ
Drejtori i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit